



Pranuar - Prilajeno Më/Dona			
09-10-2020			
Nr./ organit Org.broj	Numri/Droj	Shifra Prilog	Vlera Vrednos
02-052/01-969			

ZYRA PËR INFORMIM PUBLIK DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

## RAPORT NARRATIV

### Aktiviteti: Diskutimi Publik i Buxhetit për vitet 2021-2023,

Në bazë të Ligjit për Financa Publike dhe Përgjegjësi, Komuna e Vitisë-Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim në bashkëpunim me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, me qëllim të planifikimit të buxhetit komunal për periudhën 2021-2023 ka marrë sugjerimet e qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit komunal.

Për shkak të gjendjes së pandemisë të krijuar në vend nga virusi COVID-19, ishte pamundësuar mbajtja e takimeve kokë me kokë me qytetarët.

Megjithatë komentet e qytetarëve lidhur me planifikimin e buxhetit dhe të nevojave për investime në secilin lokalitet të komunës sonë apo në projekte konkrete janë pranuar nga data: 11.08.2020 deri 25.08.2020. duke plotësuar formularin e përgatitur nga ZIMP përmes platformës "Google Forms".

Thirrja për propozime janë bërë edhe përmes rrjetit social të komunës së Vitisë në facebook si dhe në ueb faqen zyrtare [kk.rks-gov.net/viti](http://kk.rks-gov.net/viti).

Gjithsej 20 qytetarë prej 9 lokaliteteve kanë dhënë sugjerimet e tyre për investime.

Në disa lokalitete qytetarët kanë parashtruar kërkesat e njëjta për investime. Nga ta kanë komentuar 17 meshkuj dhe 3 femra.

Më poshtë keni komentet e qytetarëve për investime.

Lokaliteti	Komentet
Beguncë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Funkcionalizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shndërrimin në ujë të pijshëm. Uji të merret në menaxhim të Kompanisë Rajonale të Ujërave "Hidromorava".</li> <li>➤ Furnizimi i banorëve me serra të vegjël, kryesisht të dimensioneve 10mx6m.</li> <li>➤ Ndërtimi i një palestre sportive (të mbyllur) për aktivitet të ndryshme sportive si: futboll, volejball, basketboll, fines etj.</li> <li>➤ Rregullimi i fushës së basketbollit.</li> <li>➤ Rregullimi i ndriçimit publik në lagjen "Arifaj".</li> </ul>
Ramnishtë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Te rregullohet ndriçimi publik në rrugën "Dardanet".</li> </ul>
Lubishtë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rregullimi i një rruge të dëmtuar.</li> <li>➤ Shënim: Komentuesi nuk ka sqaruar se ku gjendet kjo rrugë!</li> <li>➤ Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit.</li> <li>➤ Të ndahet një fond për drejtimet e veçanta të cilat janë me mungesë në Komunën e Vitisë si p.sh: Matematikë dhe Fizikë</li> <li>➤ Të krijohen më shumë mundësi për të rinjtë për punë dhe aktivitete.</li> </ul>
Mjakë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Shtruarja e rrugës së Majkut.</li> </ul>
Budrikë e Epërme	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Asfaltimin e rrugës "Hatixhe Mustafa" e cila sipas komentuesit i ka gjithsej 150 metra.</li> </ul>
Sllatinë e Epërme	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të shpallët një Konkurs Publik për asistente për fëmijët me nevoja të veçanta.</li> </ul>

<b>Potgorcë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rregullimi i ujësjellësit</li> <li>➤ Instalimi i ngrohjes qendrore në Shkollë.</li> <li>➤ Rregullimi i trotuarit</li> </ul>
<b>Qyteti i Vitisë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Në rrugën “Hasan Prishtina” në Viti të bëhet rregullimi i kanalizimit dhe të ujërave atmosferike</li> <li>➤ Intervenimi në zgjerimin e udhëkryqeve në qytet është i domosdoshëm, gjithashtu zgjerimi i rrugës “Kongresi i Manastirit” do të zgjeronte qytetin dhe do të nxiste hapjen e shume bizneseve ne këtë rruge.</li> </ul>
<b>Zhiti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Vazhdimi i asfaltimit të rrugës “Tafë Qorri”. Sipas komentuesit kjo rrugë ka një gjatësi prej 200 metra dhe janë gjithsej 5 shtëpi nga familja Osmani.</li> </ul>

Nga një kopje ju dërgohet:

1. Arkivit Komunal, z. Vetim Syla
2. Kryetarit të Komunës, z. Sokol Haliti
3. Drejtorit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, z. Ibrahim RAMA
4. Zyrës për Informim Publik, Mustafë Mehmeti

